

Takim Virtual**PREZANTIMI I ESS DHE RRJETIT RAJONAL WBESS**

9 PRILL 2021/16:00-17:00

Organizata [SCiDEV](#) dhe [Universiteti i Tiranës](#) kanë kënaqësinë t'ju ftojne në një takim virtual ku do të prezantohet **Anketa Sociale Evropiane / [European Social Survey](#) (ESS)** dhe **Rrjeti Rajonal [Western Balkans European Social Survey](#) (WBESS)**.

ESS është një vërtetim 2-vjeçar, në shkallë të gjerë, i qëndrimeve, besimeve dhe sjelljeve të popullatave në Europë që ka nisur në 2001 dhe aktualisht është në raundin e tij të 10-të. Ajo që e bën këtë vërtetim unik është metodologjia tejet rigorozë, që bën të mundur krahasimin e rezultateve mes vendeve pjesëmarrëse. Të dhënat e ESS janë të disponueshme pa pagesë dhe përbëjnë një burim të rëndësishëm për kërkuesit shkencorë dhe stafin pedagogjik.

Ky takim organizohet në kuadër të aktiviteteve të Rrjetit Rajonal WBESS – rrjet i themeluar nga [SUSTAIN II](#), një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit Horizon 2020, për të promovuar ESS në vendet e Ballkanit perëndimor. WBESS koordinohet nga Instituti i Shkencave Sociale në Beograd, dhe aktualisht ka 23 anëtarë nga 15 shtete, nga të cilët dy anëtarët e vetëm nga Shqipëria janë SCiDEV dhe Universiteti i Tiranës.

Takimi është i hapur për të gjithë stafin pedagogjik të interesuar. Për të marrë pjesë, jeni të lutur të regjistroheni [këtu](#).

Programi

15:50-16:05	Rregjistrimi i pjesëmarrësve dhe Mirëseardhje
16:05-16:20	Rëndësia e ESS dhe prezantim i WBESS Znj. Abi Dodbiba, SCiDEV & Dr. Migena Buka, UT
16:20-16:35	Eksperiencia nga realizimi i Raundit të 9-të të ESS Znj. Orkidea Xhaferaj
16:35-16:50	Pyetje dhe përgjigje Moderojnë bisedën: Dr. Visar Malaj
16:50-17:00	Komente përmbyllëse